



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. _____. 2025

V E N D I M

Nr. _____, datë _____. _____. 2025

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET E KRYERA NGA ANA E SUBJEKTEVE TË
NGARKUARA PREJ LIGJIT, ME DETYRA SPECIFIKE GJATË REALIZIMIT
TË PROCESIT TË VLERËSIMIT TË REZULTATEVE NË PUNË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë zhvillimit të procedurës së vlerësimit të rezultateve në punë për 6-mujorin e parë të vitit 2025, për nëpunësen Enxhi Zeneli,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar informacioni me shkresën me nr. 1005 prot., datë 25.11.2025, nëpërmjet të cilit nëpunësja Enxhi Zeneli, me detyrë “*Specialist (për Burimet Njerëzore)*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, ngre pretendime për parregullsi të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën 1 Janar- 30 Qershor 2025.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, nëpunësja Enxhi Zeneli, parashtrohet se, procesi i vlerësimit të rezultateve

në punë për periudhën Janar- Qershor 2025, i cili është përmbyllur në nivelin 4 “*Jo kënaqshëm*”, nuk është kryer në përputhje me procedurën e parashikuar në dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë institutin e vlerësimit të punës në shërbimin civil.

Paregullsitë e pretenduara konsistojnë kryesisht në mosrespektimin e fazave të procesit të vlerësimit, paraqitjen e të dhënave të paargumentuara për rezultatet në punë, detyrime këto të përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, të ndryshuar.

Në këto kushte, është kërkuar ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të krijuara nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë realizimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë.

Me qëllim verifikimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, vlerësoi se ka dyshime të arsyeshme për parregullsi të lejuara gjatë administrimit të shërbimit civil, e në këto rrethana ka filluar procesin e verifikimit të informacionit nëpërmjet shkresës nr.1005/1 prot., datë 3.12.2025, “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e procedurës së vlerësimit të rezultateve të punës, të nëpunëses Enxhi Zeneli, për periudhën Janar-Qershor, viti 2025*”, duke vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit paraprak të këtij rasti, nga i cili ka kërkuar edhe dokumentacionin përkatës.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, me shkresën nr. 4242/1 prot., datë 9.12.2025, me objekt: “*Dërgim dokumentacioni në lidhje me vlerësimin e nëpunëses civile znj.Enxhi Zeneli*”, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1005/2 prot., datë 11.12.2025, ka dërguar dokumentacionin në të cilin materializohen aktet që pasqyrojnë veprimet administrative që janë kryer gjatë vlerësimit individual të punës për punonjësen në fjalë, për periudhën Janar-Qershor 2025.

Nga analiza e materialeve të dërguara nga institucioni, rezulton se, me aktin nr. 135/1 prot., datë 22.1.2025, të Departamentit të Administratës Publike, nëpunëses Enxhi Zeneli, i është deklaruar statusi si “*nëpunës civil*”, në pozicionin “*Specialist (për Burimet Njerëzore)*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, klasa e pagës IV-2.

Më pas, për nevoja të institucionit, për shkak të mungesës së stafit në Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Tiranë, nëpërmjet Urdhrit nr. 23, (nr. 87/2 prot.), datë 21.1.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësja Enxhi Zeneli është caktuar përkohësisht

të ushtrojë detyrën në pozicionin “*Specialist Menaxhimi*”, në Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Tiranë, deri në një urdhër të dytë.

Nëpërmjet këtij akti administrativ, rezulton se, nëpunësja është ngarkuar me kryerjen e një detyre shtesë për nevoja të institucionit, e në këto kushte, nuk ndodhemi përpara aplikimit të institutit të “*transferimit të përkohshëm*”, në kuptim të nenit 48, seksioni 1, kreu VIII, i ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si rrjedhim, në procesin e vlerësimit të nëpunëses E. Zeneli, si zyrtarë vlerësues do të paraqiten zyrtarët e përcaktuar në organikën e institucionit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, sipas linjës së hierarkisë.

Sa i takon procedurës së ndjekur gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, sqarojmë se, në bazë të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe pikës 2, të kreut II, të VKM-së nr. 109, datë 26.2.2014, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, që ka dalë në zbatim të kësaj dispozite, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civilë të konfirmuar, është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, brenda vitit kalendarik dhe duhet të respektohen të gjitha fazat e tij, ashtu si parashikohen në pikën 12, kreu II, i aktit nënligjor në fjalë, e konkretisht:

- Planifikimi, është momenti kur Zyrtari Raportues, përcakton objektivat kryesorë të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në fazën e planifikimit përfshihet përgatitja e objektivave dhe e një plani veprimtarish për arritjen e objektivave kryesore. Objektivat kryesorë të punës duhet të jenë të matshëm, kurse veprimet të dukshme. Në këtë fazë Zyrtari Raportues dhe nëpunësi që do të vlerësohet diskutojnë së bashku qëllimet e nëpunësit për karriere, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, për periudhën e vlerësimit janë përcaktuar objektivat/aktivitetet; afati kohor për realizimin e tyre; njësia organizative ku raportohet; si edhe sektori/personi përgjegjës për kryerjen e veprimeve për realizimin e objektivave të planifikuara.

- Bisedimet e ndërmjetme, zhvillohen në mes të periudhës së vlerësimit, ku Zyrtari Raportues takohet me secilin prej nëpunësve që do të vlerësohet për të rishikuar progresin e kryer në arritjen e objektivave të planifikuara për të shprehur mendime dhe për të dhënë komente, si dhe për të evidentuar përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.

Kjo fazë e vlerësimit nuk është respektuar nga Zyrtari Raportues. Në rastin konkret, nuk rezulton të ketë ndonjë dokumentacion që materializon zhvillimin e fazës së bisedimeve të

ndërmjetme, në të cilat kalon procedura e vlerësimit të rezultateve në punë. Megjithatë, kjo parregullsi e konstatuar nuk ndikon në ligjshmërinë e procesit të vlerësimit, përderisa janë përcaktuar objektivat dhe zyrtarët përgjegjës për kryerjen e tyre, në fillim të periudhës së vlerësimit. Por, është kërkesë që duhet të realizohet gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e një procesi vlerësimi sa më objektiv, duke njoftuar edhe nëpunësin për rezultatet e arritura në mes të periudhës, me qëllim që t'i jepet mundësia për përmirësimin e tyre.

Nëse nuk pasqyrohet në një akt administrativ më vehte, ky proces duhet të materializohet në rubrikat “*Komente*” që janë në përmbajtje të formularit të vlerësimit.

- Vlerësimi përfundimtar, është një proces që ka të bëjë me vlerësimin e përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, duke respektuar afatet e vlerësimit.

Konkretisht **Ndarja C: Objektivat dhe matësit e performancës**

Rezulton se në këtë ndarje janë shënuar objektivat dhe matësit e performancës për periudhën 1.1.2025-30.6.2025, nga zyrtari i ngarkuar me këtë detyrë në aktin nënligjor.

Kjo ndarje, ka 5 rubrika vlerësimi, dhe konstatohet se në të gjitha rubrikat nëpunësi është vlerësuar nga zyrtari raportues me nivelin 4 “*Jo Kënaqshëm*” duke evidentuar komentet përkatëse në secilën rubrikë.

Ndarja C: Sjellja profesionale

Në këtë ndarje, e cila ka 8 rubrika vlerësimi, në 3 rubrika nëpunësi është vlerësuar nga zyrtari raportues në nivelin 4 “*Jo Kënaqshëm*”, në 5 rubrika është vlerësuar me nivelin 3 “*Kënaqshëm*”, duke argumentuar në rubrikën komente arsyet e këtij vlerësimi.

Në ndarjen vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë, nëpunësi është vlerësuar në nivelin 4 (*Jo kënaqshëm*).

Konstatohet se, ky proces ka përfunduar me plotësimin dhe nënshkrimin e formularit të vlerësimit nga zyrtarët vlerësues, në datën 29.10.2025. Në të njëjtën datë, nëpunësja e ka nënshkruar formularin, duke parashtruar se nuk është dakord me vlerësimin duke kërkuar rivlerësimin nga ana e Zyrtarit Autorizues.

Ndërkohë, nga ana e Zyrtarit Autorizes (*i komanduar*) **është kryer** procesi i rivlerësimit të rezultateve në punë, ku është plotësuar ndarja “*DH*”, e formularit “*Rivlerësimi nga zyrtari autorizues*”, në datën 6.11.2025, pas kërkesës së nëpunëses për rivlerësim, në përputhje me kërkesat e pikës 9, kreu IV, të vendimit nr.109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave,

“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, në përfundim të të cilit Zyrtari Autorizues ka mbajtur të njëjtin qëndrim.
Nëpunësja është njohur me rezultatin e rivlerësimit në datën 11.11.2025.

Referuar problematikës së evidentuar më sipër, sa i takon afateve të kryerjes së procesit të vlerësimit të nëpunësës, vlerësojmë se, zyrtarët vlerësues të përfshirë në këtë proces, duhet të tregojnë kujdes për respektimin e kërkesave të parashikuara në germën c), pika 12, kreu II, i VKM-së nr. 109, datë 26.2.2024, e ndryshuar, ku përcaktohet se: vlerësimi përfundimtar për secilën periudhë vlerësimi realizohet përkatësisht në periudhën 1–15 korrik dhe 1–15 janar. Vonesat në këto afate, sjellin përgjegjësi disiplinore për zyrtarin vlerësues. Megjithatë, realizimi i këtij procesi jashtë afateve të parashikuara, nuk ndikon në ligjshmërinë e procesit, në kushtet kur, nuk sjell ndonjë pasojë në rezultatin e procesit apo në respektimin e të drejtave të nëpunësit të vlerësuar.

Në këto rrethana, duhet të sjellim në vëmendje të zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, se ky sistem vlerësimi është një proces i rëndësishëm, i cili konsiston në verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Ai i shërben përmirësimit të aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit dhe ka pasoja të rëndësishme për nëpunësin civil, pasi shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me mundësinë e zhvillimit të karrierës nëpërmjet ngritjes në detyrë, lirimin nga shërbimi, përparimin në hapat e pagës, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit nr. 1005 prot., 25.11.2025, të paraqitur nga nëpunësja Enxhi Zeneli, me objekt verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit, me detyra specifike gjatë realizimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, meqënëse procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është kryer në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil.

2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Ministria e Mjedisit, si dhe nëpunësja Enxhi Zeneli.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)

Punoi: F. Doksani

Pranoi: L. Zhapa

Miratoi: A. Basha